



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026  
I DETYRUAR - SESIONI I  
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**

**SKEMË VLERËSIMI**

**Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe arsimi profesional**

**Varianti A**

*9 qershor 2026*

**Shënim:** Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, të cilat kanë më shumë mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh dhe me përgjigje të përafërta.

**Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit**

**PJESA I**

**Lumturia gjendet vetëm brenda vetes**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë
Pyetja 8	D	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	C	1 pikë

**Pyetja 11**                      **3 pikë**

**Përgjigje e plotë:**

Sipas tekstit, lumturia varet nga:

- vullneti i njeriut.
- idetë që ai formon për ngjarjet.
- mënyra se si i përdor idetë e tua.

**2 pikë**                      Nëse nxënësi identifikon dy detaje.

- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon një detaj.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Koha:** E tashme

**Shpjegimi:** Koha e tashme përdoret për të shprehur të vërteta të përgjithshme, universale dhe filozofike, që vlejnë në çdo kohë dhe për çdo njeri. Kjo i jep tekstit karakter **bindës, aktual dhe gjithëkohor**.

- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon kohën e foljes.  
**1 pikë** Nëse nxënësi shpjegon arsyen.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 13** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Sipas autorit, fama është gënjeshtare, pasuria dhe pushteti janë gjëra sipërfaqësore që nuk garantojnë lumturi të vërtetë. Autori argumenton se ato mund të mashtrojnë individin, pasi krijojnë një pamje të rreme të suksesit. Lumturia, nëse mbështetet vetëm në to, bëhet e paqëndrueshme dhe e varur nga faktorë të jashtëm, duke çuar shpesh në zhgënjim.

- 1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm shpjegimin pa ilustrime.  
**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm ilustrimet.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 14** **3 pikë**

**Përgjigje e plotë**

**Përemri** -vetes

**Lloji** -vetvetor

**Funksioni sintaksor** - kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

- 1 pikë** Nëse nxënësi identifikon llojin e përemrit.  
**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon llojin e përemrit.  
**1 pikë** Nëse nxënësi identifikon funksionin sintaksor.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 15** **2 pikë**

**Përgjigje e plotë:**

**Gjymtyrët homogjene:** zilisë dhe dëshpërimit

**Funksioni sintaksor:** përcaktor (me drejtim)

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen gjymtyrët homogjene.

- 1 pikë** Nëse nxënësi dallon funksioni sintaksor.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 16** **2 pikë**

**Përgjigje e plotë**

*Lumturia varet nga vullneti dhe përdorimi që u bëj ideve të mia.*

- 2 pikë** Nëse nxënësi bën dy ndryshimet.  
**1 pikë** Nëse nxënësi bën vetëm njërin nga ndryshimet.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 17** **2 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Struktura:** Fjalja e fundit thekson idenë e përmirësimit të vetvetes, ide të cilën autori e mbron gjatë tekstit . Ajo përmbledh mesazhin kryesor të tekstit: njeriu duhet të përqendrohet te vetja dhe tek ajo që ka në dorë, jo tek imitimi i të tjerëve. Rimerr tezën dhe bën përfundimin e arsyetimit.

**Veçoria gjuhësore:** Nga pikëpamja gjuhësore ajo është fjali me folje në vetën e dytë në mënyrën urdhërore.

- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen njërin nga dy veçoritë.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**PJESA II**

**HOMERI**

**Iliada**

- |        |    |   |        |
|--------|----|---|--------|
| Pyetja | 18 | B | 1 pikë |
| Pyetja | 19 | C | 1 pikë |
| Pyetja | 20 | C | 1 pikë |
| Pyetja | 21 | D | 1 pikë |
| Pyetja | 22 | A | 1 pikë |
| Pyetja | 23 | D | 1 pikë |
| Pyetja | 24 | A | 1 pikë |
| Pyetja | 25 | C | 1 pikë |
| Pyetja | 26 | D | 1 pikë |
| Pyetja | 27 | B | 1 pikë |

**Pyetja 28** **1 pikë**

**Përgjigje e plotë**

“Kot mos dërdëllitni këtu tëhu duke më ndenjurr rotull.”

- 1 pikë** Nëse nxënësi dallon vargun.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 29** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Shpjegimi:** Akili i zemëruar, kupton se kanë përfutuar nga krahu dhe aftësia e tij në luftë dhe i nxit të gjithë të rebelohen e të mos i binden më Agamemnonit se mund ta pësojnë si ai.

**Ilustrimi:** u këshilloj të gjithëve drejt tokës sonë të çajne bashet e anijeve.

**Përgjigje e pjesshme:** Akili i nxit të largohen nga lufta

<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi jep shpjegimin e plotë dhe ilustrimin.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi jep shpjegim të pjesshëm dhe ilustrimin.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi jep shpjegim të pjesshëm.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi jep vetëm ilustrimin.
<b>0 pikë</b>	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

**Pyetja 30****3 pikë****Model përgjigjeje:**

**Ndjenja:** Akili e urren Agamemnonin.

**Shpjegimi:** Akili ndihet i fyer dhe i poshtëruar sepse ka luftuar dhe nuk është vlerësuar, madje është nëpërkëmbur. Sakrificat e tij nuk është vlerësuar nga Agamemnoni, i cili i ka rrëmbyer skllaven që Akili kishte për zemër.

**Ilustrimi:** Atë njeri e urrej si dyer skëterre

<b>3 pikë</b>	Nëse nxënësi jep përgjigje të plotë.
<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen dy nga pikat e kërkesës.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen vetëm njërin prej tyre.
<b>0 pikë</b>	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

**Pyetja 31****2 pikë****Model përgjigjeje:**

**Raporti:** Briseida është skllavja e Akilit, por ai është i dashuruar me të, ndaj edhe zemërimi i tij ndaj Agamemnonit është aq i madh.

**Ilustrimi:** e robita në betejë me shpatë; **ose** edhe unë atë me gjithë shpirt e doja

<b>2 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen raportin dhe ilustrimin.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen vetëm raportin.
<b>1 pikë</b>	Nëse nxënësi gjen vetëm ilustrimin.
<b>0 pikë</b>	Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32****2 pikë****Model përgjigjeje:**

**Karakter:** Agamemnoni shfaqet si arrogant, mashtrues, egoist e gënjeshtar.

**Ilustrimi:** që tjetër ndien e tjetër nxjerr nga goja”, meqë m’gënjeu e dhunë të poshtër m’bëri.

- 2 pikë** Nëse nxënësi zbulon karakterin dhe jep ilustrimin .  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm karakterin.  
**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetën ilustrimin.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

**Pyetja 33** **2 pikë**

**Përgjigje e plotë**

**Ilustrimi:** pse Zeusi dinaku ia ka prishur mendjen

**Ilustrimi:** Im' ëmë hyjnesha Tetis këmbargjendta / më tha dy fate m'dalin gjer n'vdekje

- 2 pikë** Nëse nxënësi jep dy ilustrime  
**1 pikë** Nëse nxënësi jep vetëm një ilustrim.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
- 

**Pyetja 34** **3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

**Funksioni:** Retrospektiva shërben për të kujtuar dy zgjedhjet para të cilave e vë e ëma para se Akili të nisej për në Trojë.

**Shpjegimi:** Akili ka zgjedhur lavdinë e përjetshme. Fakti që tani heq dorë prej saj tregon sa fort është lënduar nga sjellja e Agamemnonit.

- 3 pikë** Nëse nxënësi dallon funksionin e retrospektivës dhe jep shpjegimin.  
**2 pikë** Nëse nxënësi dallon funksionin e retrospektivës dhe nuk jep shpjegim të plotë.  
**1 pikë** Nëse nxënësi dallon vetëm funksionin e retrospektivës.  
**0 pikë** Nëse nxënësi përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë jep një formulim më ndryshe se modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

---

### **PJESA III**

**Pyetja 35** **8 pikë**

Për pjesën ese do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

**Shtjellimi i idesë** **2 pikë**

- shkruan një ese, e cila mbështetet në mënyrën se si leximet apo përvojat personale të nxënësit ndikojnë në krijimin e versionit më të mirë të vetes;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat kanë ndikuar në jetën e tij;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;

- sjell përftyryrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e temës së dhënë .

**Organizimi dhe struktura 2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

**Stili dhe origjinaliteti 2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

**Saktësia gjuhësore 2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

**Shënim:** Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.

